



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1120 Prot.

Tiranë, më 29.12.2017

VENDIM

Nr.250, datë 29.12.2017

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 134, DATË 14.06.2017,
NË INSTITUCIONIN E MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 134, datë 14.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë në datën 13.6.2017, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Plarent Ndreca në lidhje me pezullimin e tij nga shërbimi civil”, në institucionin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

KONSTATOVA SE:

Në datën 13.06.2017, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është regjistruar kërkesa me nr. 1120/7 prot., e nëpunësit Plarent Ndreca, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me objekt: “Konstatimin e aktit administrativ, Urdhrit nr. 7/Extra, datë 13.06.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, si akt absolutisht i pavlefshëm”. Komisioneri për këtë rast ka filluar hetimin administrativ, gjatë të cilit ka shqyrtuar dhe administruar gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 134, datë 14.06.2017, në të cilin është vendosur:

“1. Të kërkoj nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, Urdhrit nr. 7/Extra Prot., datë 13.06.2017, “Për pezullimin nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit

dhe Sportit”, të nxjerrë prej tij, si dhe të anulojë çdo akt administrativ që ka dalë në bazë dhe për zbatim të këtij akti.

2. Të rikthejë në detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit, punonjësën Plarent Ndreca.”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 134, datë 14.06.2017, me shkresën nr. 1834 prot., datë 30.11.2017, “Mbi zbatimin e Vendimit Nr. 134, datë 14.06.2017, “Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë në datën 13.6.2017, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Plarent Ndreca në lidhje me pezullimin e tij nga shërbimi civil””, ka filluar verifikimin e zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Enkelejda Hebibasi, Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Stela Ndoka, Specialist pranë kësaj drejtorie, të cilët në datën 04.12.2017, u paraqitën në insitucionin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Grupi i punës, gjatë vizitës në institucion komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin paralajmërues. Dokumentacioni shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit është materializuar në procesverbalin e datës 04.12.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit të institucionit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në pikat 1 dhe 2 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit të konstatojë pavlefshmërinë absolute të Urdhrit Nr. 7/Extra prot., datë 13.06.2017, “Për pezullimin nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, të anulojë çdo akt tjetër administrativ që ka dalë në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe të rikthejë në detyrë punonjësën.

Nga komunikimi me Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse, grupi i punës u informua se punonjësi Plarent Ndreca ka vazhduar të kryejë detyrën pa u shkëputur për asnjë moment pavarësisht urdhrin për pezullimin e tij nga detyra (aktualisht, ***** kryen detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit).

Nga ana tjetër, Ministria e Arsimit dhe Sportit me Urdhrit Nr. 439, datë 26.09.2017, ka konstatuar si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm Urdhrit nr. 7/Extra prot., datë 13.06.2017, “Për pezullimin nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”, në përputhje me përcaktimet e neneve 108 dhe

110, 111 të Kodit të Procedurave Administrative dhe rekomandimet e Komisionerit në vendimin paralajmërues.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 134, datë 14.06.2017, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë në datën 13.6.2017, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Plarent Ndreca në lidhje me pezullimin e tij nga shërbimi civil”*, të Komisionerit, rezulton se nga ana e institucionit Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 134, datë 14.06.2017, *“Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë në datën 13.6.2017, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Plarent Ndreca në lidhje me pezullimin e tij nga shërbimi civil”*, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë .
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 134, datë 14.06.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi Plarent Ndreca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha